



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/296

Datë: 15.06.2022

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17, nenit 40 paragrafi 2 shkronja (h), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.28/15 qershor 2008", bazuar në nenin 9 paragrafi 3 shkronja (b), nenit 10, nenit 19 paragrafi 1 shkronja (a), të Statutit të Komunës së Malishevës Nr.01/871 datë:12.11.2008, Vendimit Nr.02/514 datë: 12.09.2029, propozimit Nr.01/867 datë: 06.06.2022 të Këshillit Organizativ, Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledhjen e mbajtur më datë: 13.06.2022, merr këtë:

V E N D I M


1. Z. Haxhi Berisha nga fshati Gurbardh, Komuna e Malishevës i ndahet çmimi "**Hamdi Berisha**" - për kontributin e dhënë në Shkollën Shqipe.
2. Bazuar në pikën 1 të këtij vendimi, çmimi i ndahet nga Kuvendi i Komunës së Malishevës më datë: 13.06.2022 dhe i njëjti mbështetet në Statutin e Komunës së Malishevës.
3. Çmimi do të jepet publikisht më datë: 16.06.2022 me rastin e shënimit të 23-vjetorit të Ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve të Komunës së Malishevës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, përmes drejtorive komunale.
5. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 81, të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen lokale, si dhe në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Rregullores (QRK) nr.10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe plotësuar, me Rregulloren (QRK) nr.06/2021, përkatësisht pas shpalljes në faqen zyrtare të Komunës së Malishevës.

Vendimi ju dërgohet
Arkivit të Komunës
MAPL-së
Drejtorive të KK-së.





REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS



Kryetari i Komunës

Nr. 01/867

Datë: 06/06/2022

Nga:

Kryetari i Komunës së Malishevës

-Kryetar i Këshillit Organizativ, Ekspert

Për:

Kuvendin e Komunës së Malishevës

Datë:

06.06.2022

Kopje:

Arkivit të komunës

Lënda:

Propozim për miratim të vendimit të Këshillit Organizativ, për ndarjen e mirënjohjeve konform nenit 9 të Statutit të Komunës së Malishevës.

Të nderuar anëtar të Kuvendit të Komunës së Malishevës,

Këshilli Organizativ i formuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës, Vendimi nr.02/212, të datës 05.05.2022, pas shqyrtimit të propozimeve të bëra nga anëtarët e Këshillit, vendosi që në pajtim me nenin 9 të Statutit të komunës së Malishevës, të nominojë këto personalitete.

Këshilli Organizativ, i propozon Kuvendit të Komunës së Malishevës për miratim:

Për çmimin "Imer Krasniqi" Këshilli Organizativ, vendosi që të dërgon në kuvend propozimet e Shoqatës së Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare-dega në Malishevë;

- 1. Shefqet Paçarizi (pas vdekjes).
- 2. Shpëtim Hazrolli (pas vdekjes)

Për çmimin "Hamdi Berisha" për kontributin e dhënë në shkollën shqipe,

- 1 z. Kapllan Krasniqi.
- 2 z. Haxhi Berisha.

Për çmimin "Shpëtim Këbaj" për kontributin e dhënë në fushën e shëndetësisë;

- 1. Inf. Ismet Morina (pas vdekjes).
- 2. Dr. Gëzim Krasniqi.

Ju faleminderit për mirëkuptim !

Me respekt,

Zyra e Kryetarit të Komunës
Rruga "Gjergj Kastrioti - Skenderbeu" - pn
24000- Malishevë